

VENDIM
Nr. 36, datë 24.1.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 673, DATË 22.11.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR RIORGANIZIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË
SË INFORMACIONIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën nr. 2, kolona “Sistemi/ infrastruktura”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, emërtesat “Sistemi i menaxhimit të çështjeve të gjyqësorit (ICMIS)” dhe “Sistemi i menaxhimit të çështjeve të gjyqësorit (ICMIS) në gjykatat administrative” hiqen.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi